V E N D I M
Nr.197, datë 6.4.2001

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pagat e punonjësve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Në lidhjen Nr.1 "Renditja e funksioneve sipas klasifikimit" bëhen këto shtesa:

a) Në shkronjën "A4" shtohen emërtimet

"- Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

- Zëvendëskryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

- Anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.".

b) Në shkronjën "A7" shtohet emërtimi "Sekretar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve".

c) Në shkronjën "B1" shtohen emërtimet:

"- Drejtor i Regjistrit Kombëtar të Zgjedhësve

- Drejtor i Komisioneve Zgjedhore

- Drejtor i Drejtorisë Juridike.".

ç) Në shkronjën "B2" shtohen emërtimet:

" – Drejtor Drejtorie në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

- Jurist në Drejtorinë Juridike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.".

d) Në shkronjën "B3" shtohen emërtimet:

- Zëdhënës në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

- Informaticien në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

- Ndihmës i Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.".

dh) Në shkronjën "B4" shtohen emërtimet:

"- Inspektor në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

- Në paragrafin përgjegjës sektori në Presidencë, në Këshillin e Ministrave dhe Kuvend shtohet "dhe në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.".

e) Në shkronjën "C2" shtohen emërtimet:

"- sekretare e anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

- në paragrafin "redaktor, bibliograf, përkthyes, stenograf, asistent, inxhinier, inspektor, ekonomist, specialist në presidencë, në Këshllin e Ministrave, në Kuvend shtohet, "edhe në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta